



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
“CHARLES TELFORD ERICKSON”
Golem — Kavaje

shkollaemesmeagrobiznesgolem@yahoo.it

Tel.0682063499 .

Nr. 348 prot

Golem më 15.08 ., 2025.

Lenda: Njoftim per vend pune te lire.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË Ë MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar, vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”, i ndryshuar, udhëzimit nr.759, dt.30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”,

Ofruesi publik i AFP-se, Shkolla e Mesme Profesionale Charles Telford Erickson” Golem-Kavaje ju njofton krijimin e vendit te lire per pozicionin:

-Mesues i teorise dhe praktikes profesionale me kohe te plote per drejtimin:Ekonomi-Biznes.

Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posacme.

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë këto kriteret:

1. Kriteret e përgjithshme:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar.

- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit.
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Krite të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional:

- a) Të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-se.
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi.
- c) Kartën e identitetit.
- d) Diplomën;
- e) Librezën e punës;
- f) Cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- g) Certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- h) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) Vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
- k) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates. 27.08.2025.

Drejtore

Matilda Canaku

